

Menaxhimi Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme – Fokusi te bizneset e vogla të Ekonomisë Blu

Përgatiti: Prof.Asoc. Rezarta Perri

Drejtimi i një ndërmarrjeje të vogël dhe të mesme (NVM) mund të jetë sfidues sidomos në tregje që karakterizohen nga një nivel i lartë risku dhe pasigurie që bën që norma e dështimit të bizneseve të vogla të jetë tejet e lartë dhe shpesh dekurajuese. Por nga ana tjetër, NVM janë kritike për suksesin e një ekonomie në tërësi dhe për këtë arsye ato kanë nevojë për mbështetje dhe nxitje në fazat e para të hapjes së tyre në mënyrë që të kalojnë me sukses vitet e para kritike të jetës dhe të ecin drejt shndërrimit në ndërmarrje të konsoliduara dhe të shëndetshme në treg.

Qëllimi i këtij moduli është të japë më shumë informacion në lidhje me bazat e menaxhimit financiar të bizneseve të vogla dhe të mesme. Cilat janë njohuritë kryesore të kontabilitetit dhe planifikimit financiar që duhet të aplikojë një NVM? Cilat janë alternativat e financimit të tyre? Cilat janë pikat kritike të menaxhimit të përditshëm të tyre? Fokusi do të jenë NVM në të ashtuquajturin “sektori blu”, pra ndërmarrje të hoteleri – turizmit, agjensi turistike, etj, një ndër elementet më të rëndësishme të zhvillimeve të fundit në vendin tonë.

Më poshtë renditen disa objektiva të këtij moduli:

- Rëndësia e menaxhimit financiar për Bizneset e Vogla dhe të Mesme;
- Praktikat, rregullat dhe mjetet e menaxhimit financiar që janë zakonisht në dispozicion të NVM;
- Bazat e kontabilitetit dhe raportimit për NVM. Pasqyrat financiare kryesore;
- Menaxhimi i flukseve monetare të bizneseve të vogla;
- Buxhetimi dhe rëndësia e tij;
- Rregullat e raportimit tatimor dhe fiskalizimi;
- Financimi i aktivitetit të NVM;

Rëndësia e menaxhimit financiar për Bizneset e Vogla dhe të Mesme

Studimet tregojnë se mungesa e njohurive financiare dhe e informacionit për menaxhimin kontabël dhe financiar mund të bëhen shkak për performancën e dobët të NVM. (OECD Report,

2016). Shpesh, bizneset e vogla marrin vendime të gabuara ose jo të informuara për shkak të paaftësisë së tyre për të identifikuar se cilët janë treguesit e rëndësishëm për performancën dhe menaxhimin e tyre.

Sipas disa të dhënave që vijnë nga SHBA¹, vetëm rreth 80% e bizneseve të vogla të hapura mes 2005 dhe 2017 mundën t'i mbijetonin vitit të parë të aktivitetit. Fatkeqësisht, vetëm gjysma e këtyre bizneseve ia dolën mbanë të mbijetonin në treg deri në vitin e pestë të aktivitetit të tyre. Dhe vetëm një ndër tre biznese të vogla zakonisht arrin të kapërcejë pragun e 10 vjecarit të parë të aktiviteteve të tyre. Të dhënat që vijnë nga SHBA fare mirë mund të replikohen edhe për vendetë tjera në botë. Ka sigurisht shumë arsye përse NVM falimentojnë apo nuk kanë sukses, por mungesa e aftësive në menaxhimin e performancës financiare dhe në vlerësimin dhe vendimmarrjen financiare është një ndër shpjegimet që dalin më shpesh në pah nga studime të shumta.

Përfitimet e menaxhimit financiar të një njësie ekonomike

Si drejtues, menaxher apo pronar i një biznesi, menaxhimi financiar cilësor ju ofron shumë përfitime dhe mund të jetë një ndër mjetet kryesore për suksesin tuaj. Çfarë nënkuptohet në përgjithësi me termin menaxhim financiar, apo *drejtimi financiar i biznesit është tërësia e praktikave kontabël, mbajtja e llogarive dhe raportimeve tatimore periodike, parashikimet dhe buxhetimet e ndryshme, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore dhe të dhëna e informacione për financimin dhe likuidimin e tij*. Të gjitha këto elemente zakonisht janë të nevojshme që një biznes të arrijë qëllimet e tij përmes vendimmarrjeve të mirë-informuara.

E thënë më thjeshtë, menaxhimi financiar ju jep mundësinë të dini, a keni fitim apo humbje; menaxhimi financiar ju jep mundësinë të vendosni nëse mund të përballoni financiarisht hapjen e një pike të re të aktivitetit ose jo; blerjen e mallrave dhe pajisjeve; punësimin e punonjësve, etj. Ju gjithashtu keni nevojë për menaxhimin financiar që të mund të vendosni çmime që mbulojnë kostot tuaja, të vendosni nëse ka leverdi për të blerë nga një furnitor apo nga një tjetër; ka leverdi të pranohet kërkesa e një klienti apo e një klienti tjetër.

Menaxhimi financiar ju jep mundësinë të planifikoni rritjen e biznesit, zgjerimin në tregje të reja apo prezantimin e produkteve dhe shërbimeve të reja. Me mjete efektive të menaxhimit financiar ju mund të planifikoni se çfarë drejtimi do t'i jepni firmës tuaj në të ardhmen dhe të planifikoni edhe pasojat financiare të këtyre vendimeve e të zgjidhni mes alternativave të ndryshme para se të jetë tepër vonë. Nëse do të keni nevojë për financime të aktivitetit në të ardhmen, menaxhimi

¹ <https://www.census.gov/data/datasets/2018/econ/susb/2018-susb.html>

financiar ju jep një ide se ku mund të gjeni fonde dhe si të organizoni aktivitetin për të qenë në gjendje të shlyeni këto hua. Në terma më praktikë dhe konkretë, menaxhimi financiar ju siguron edhe dokumentacionin që ju kërkohet nga bankat apo kreditorët në mënyrë që të miratohet dhe lëvrohet kredia e kërkuar.

Kontabiliteti dhe pasqyrat financiare

Kontabiliteti është procesi i organizuar i regjistrimit dhe dokumentimit të të dhënave që vijnë nga transaksione financiare dhe ngjarje biznesi. Sa herë që firma blen, shet, ofron shërbime, paguan punonjësit apo faturat, të gjitha të dhënat në lidhje me këto ngjarje financiare duhet të ruhen diku, në një mënyrë të organizuar e cila lejon jo vetëm përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e informacionit që kërkohet nga palët e interesuara (shteti, bankat, pronari), por edhe të arshivohen në një mënyrë llogjike me qëllim tërheqjen e informacionit në të ardhmen atëherë kur do dalë nevoja të përdoret sërish (psh në një kontroll nga organet tatimore).

Në lidhje me kontabilitetin ka disa hapa që sugjerohet të ndiqen nga bizneset e vogla:

1. Siguroni një paketë softuerike për mbajtjen e kontabilitetit (Alpha, ose Financa 5 janë ndër softuerët kontabël më të përdorur në Shqipëri).
2. Hapni llogari bankare të veçanta për biznesin. Asnjëherë mos përzieni transaksionet e biznesit me ato individuale/personale. Përdorni këtë llogari bankare për të gjitha transaksionet (arkëtime dhe pagesa) që kanë të bëjnë me biznesin tuaj.
3. Nëse është e nevojshme hapni një linjë kredie apo një kartë krediti të veçantë për nevojat e biznesit tuaj në emrin e biznesit.
4. Regjistroni në sistem të gjitha të dhënat në bazë të përditshme (ose të përjavshme për bizneset me pak volum të dhënash) dhe një herë në muaj bëni rakordimet e nevojshme me klientët / furnitorët para se të bëni deklaratimet në organet tatimore.
5. Më së pari, paguani të gjitha detyrimet e biznesit dhe më pas *“kërkoni rrogën tuaj”*. Shumica e biznesve të vogla nisin si firma me një pronar dhe në këto firma, pronari nuk merr rrogë, por mund të tërheqë fonde nga firma. Çështja shtrohet: sa fonde mund të tërheqë? Një rregull i thjeshtë: *“të ardhurat përdoren për të mbuluar së pari shpenzimet e biznesit tuaj dhe më pas shpenzimet tuaja personale”*.

6. Përgatitni një pasqyrë të ardhurash dhe shpenzimesh (e prezantuar më poshtë). Llogaria bankare apo paratë që keni në arkë nuk janë një tregues i besueshëm i situatës së përfitueshmërisë, pasi mund të keni shumë detyrime të palikuduara apo edhe të ardhura që akoma nuk i keni arkëtuar nga klientët. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve ndjek një format dhe rregulla specifike për përgatitjen e saj (mund t'ju duhet ndihma e një studioje kontabël për të përgatitur në mënyrë korrekte) dhe ju jep një pamje të saktë të situatës së përfitueshmërisë suaj.
7. Nëse pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve tregon se keni fitim, mund të paguani veten tuaj duke bërë tërheqje nga llogaria bankare e biznesit.

Pasqyra e flukseve monetare dhe parashikimi i tyre

Një ndër elementet më të rëndësishme të menaxhimit të një biznesi të vogël është menaxhimi i flukseve të mjeteve monetare. Por çfarë janë flukset e mjeteve monetare apo thjesht flukset e parasë?

Ato mund të përcaktohen në dy mënyra:

1. Teprica e parave që keni arkëtuar nga klientët minus paratë që keni paguar për të gjitha faturat.
2. Diferenca mes gjendjes së parave që dispononin në fillim të periudhës/aktivitetit me gjendjen e parave që keni në fund të periudhës/aktivitetit.

Çfarë ka shumë rëndësi për flukset e parasë është jo vetëm gjendja e tyre aktualisht por parashikimi i tyre për të ardhmen shpesh përmes një pasqyre të veçantë që merr emrin “pasqyra e parashikimit të flukseve të parasë”. Kjo pasqyrë rreket të tregojë/parashikojë sa para pritet të arkëtohen në të ardhmen (nga klientët, grante të ndryshme nëse këto janë të mundura apo edhe kontribute të pronarit) dhe sa para pritet të paguhet (për blerje, punonjësit, tatime e taksa, fatura, bankave, etj). Qëllimi i pasqyrës është të shohë nëse në fund të një periudhe (një vit apo disa vite), firma do ketë më shumë arkëtime sesa pagesa pra një gjendje pozitive në arkë (e njohur si suficit i arkës) apo gjendje mungese të parave (deficit i arkës) kur pritet të bëjë më tepër pagesa sesa arkëtime.

Kujdes! Një biznes mund të ketë fitim e përsëri mund të mos ketë likuiditete (kur vonohen arkëtimet nga klientët, por kur pagesat dhe faturat nuk presin!) Një pasqyrë e parashikimit të flukseve monetare ju ndihmon të keni vëmendje në ato fragmente kohore kur do t'ju duhet të bënipagesa të larta dhe të planifikoni në kohë sesi do t'i mbuloni nevojat tuaja për ato periudha.

Një

pasqyrë e tillë madje mund t'ju tërheqë vëmendjen edhe ndaj pagesave më të larta sesa duhet duke ju bërë të planifikoni më mirë. Ka biznese që i përdorin këto pasqyra edhe për të llogaritur pikën kritike të aktivitetit, pra *sa shërbime duhet të ofroni që të mund të mbuloni të gjitha shpenzimet tuaja?* Një pasqyrë e tillë është shumë praktike edhe kur po planifikoni të blini një pajisje të kushtueshme, apo kur keni biznese me natyrë ciklike (si shumica e bizneseve të vogla në sektorin blu) dhe ju duhet të planifikoni të ardhurat për një kohë të shkurtër por shpenzime për një kohë më të gjatë. Në mënyrë të përmbledhur, pasqyra e të ardhurave dhe e shpenzimeve mund të „fshehtë“ mungesat e likuiditeteve pasi përdor një parim të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (të ardhurat regjistrohen jo kur arkëtohen por kur plotësojnë kriteret kontabël të regjistrimit; shpenzimet regjistrohen jo kur paguhet por kur plotësojnë kriteret kontabël përkatëse). Përkundrazi, pasqyra e flukseve të parasë fokusohet në gjendjen e likuiditeteve dhe ju zbulon sa të aftë jeni që me paratë që arkëtoni nga klientët të mbuloni pagesat e nevojshme. Jo vetëm kaq, por kjo pasqyrë ju zbulon dhe dinamikën kohore të hyrje/daljeve të parave.

Një spreadsheet i pasqyrës së parashikuar të flukseve monetare.

Le të shohim një shembull sesi përpilohet një parashikim i flukseve monetare.

	Zerat e buxhetit	Prill	Maj	Qershor	Totali
	<i>Arka ne fillim</i>	XXXXX	XXXXX	XXXXX	XXXXX
plus	<i>Arketime nga klientet</i>	XXXXX	XXXXX	XXXXX	XXXXX
	<i>Arketime te tjera (grante, pronari, etj)</i>	XXXXX			
baras	Mjete Monetare totale ne dispozicion	XXXXX	XXXXX	XXXXX	XXXXX
minus	<i>Pagesa (harxhime / dalje nga arka)</i>	XXXXX	XXXXX	XXXXX	XXXXX
	Per blerje te mallrave	XXXXX	XXXXX	XXXXX	XXXXX
	Per paga te paguara	XXXXX	XXXXX	XXXXX	XXXXX
	Shpenzime qeraje	XXXXX	XXXXX	XXXXX	XXXXX
	Shpenzime energji dhe uje	XXXXX	XXXXX	XXXXX	XXXXX
	Harxhime totale	XXXXX	XXXXX	XXXXX	XXXXX
baras	Mbetja ne arke	XXXXX	XXXXX	XXXXX	XXXXX
	Nevoja totale per financimin	XXXXX	0	-	
	<i>Financimi i arkes</i>				

Huamarrje te reja				
Pagesa e principalit te huave ekzsituese				
Pagesa e interesit				
Financime totale				
Arka ne fund	XXXXX	XXXXX	XXXXX	XXXXX

Rreshtat e parë që titullohen *Arkëtimet e parave* tregojnë hyrjet e parave nga arkëtimet nga klientët, që janë edhe hyrjet e rregullta dhe afatgjata për biznesin, por edhe arkëtime të tjera si psh, nga grante që mund të merren nga qeveria, nga interesa që mund të fitohen nga llogaritë e biznesit pranë bankave, etj.

Seksioni i dytë i pasqyrës së flukseve monetare të parashikuara liston të gjitha pagesat e arave që lidhen me shpenzimet e përditshme operative të biznesit, si pagesa për furnitorët për mallra dhe shërbime të blera, paga të paguara për punonjësit, pagesa e shpenzimeve të energjisë elektrike dhe faturave të tjera utilitare, pagesa e qerasë, etj. Në këtë seksion normalisht do të përfshiheshin edhe pagesat e parave (nëse do të kishte) për blerjen e makinerive dhe pajisjeve, tatimeve dhe taksave, etj.

Diferenca mes parave totale në dispozicion (shuma e gjendjes në fillim të arkës plus të gjitha arkëtimet e parashikuara) me totalin e pagesave të parashikuara na jep *mbetjen në arkë* e cila në varësi të situatës mund të jetë pozitive (pra kemi më shumë arkëtime sesa pagesa dhe kjo gjendje njihet si suficit), ose negative (atëherë kur kemi më shumë pagesa sesa arkëtime dhe kjo gjendje njihet si deficit i arkës).

Në varësi të mbetjes në arkë, planifikojmë edhe financimin e saj në seksionin e fundit, që njihet si financimi i arkës. Këtu listohen të gjitha huatë e reja që mund të ketë të nevojshme të marrë biznesi, ose pagesat e huave ekzistuese (që janë marrë në të kaluarën) së bashku me interesin përkatës. Gjendja e arkës në fund të një muaji bëhet gjendja në fillim të muajit pasardhës e kështu vijon cikli i parashikimit të mjeteve monetare.

Buxhetet

Shpesh parashikimi i flukseve monetare mund të duket kompleks për t'u realizuar nga punonjësit e një biznesi të vogël (pa asistencën e një suporti të specializuar financiar) e për këtë arsye, hasim ato që njihen si buxhete. Krijimi i një buxheti është dicka e natyrshme për individët dhe bizneset

e vogla dhe konsiderohet si ndër hapat fillestare të praktikimit të menaxhimit financiar të NVM-ve. E thënë thjesht, një buxhet është një listë e shpenzimeve tuaja (vjetore ose mujore) e organizuar në kategori ose zëra të ndryshëm.

Një buxhet është një mjet që na ndihmon të:

- Gjurmojmë të gjitha shpenzimet e biznesit
- Planifikojmë për të ardhmen
- Kursejmë kur është e nevojshme
- Planifikojmë për zgjerim
- Realizojmë fitimin

Buxhetet janë mjete shumë të mira që ju ndihmojnë që të krahasoni shifrat e buxhetuar me ato faktike dhe të analizoni shmangiet para se të jetë shumë vonë.

Ushtrim me buxhetimin.

Listoni më poshte kategoritë / zërat e buxhetit që përdorni zakonisht (fatura OSHEE, UKT, Paga, Blerje, Tatime, etj)

Kategoria e shpenzimit	Buxheti Mujor	Shpenzimet faktike
Qera		
Energji, ujë		
Telefon, Internet		
Siguracione		
Paga		
Furnizime për zyrën		
Materiale dhe furnitura		
Licenca		
Transport / udhëtime		
Tarifa abonimi / anëtarësie		
Taksa		
Interesa		
Tërheqje të pronarit		

Raportimi periodik tatimor dhe kontabël i bizneseve të vogla në Shqipëri

Bizneset e vogla të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën e agroturizimit, hotelerisë apo agjensitë e udhëtimit, duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës ku do të përmendja ligjin Nr. 93/2015 „Për turizmin“. Aktiviteti i tyre kontrollohet nga inspektoriate të veçanta të cilat kanë për qëllim të garantojnë cilësinë e shërbimit për klientët. Ato pajisen me liçensa apo leje të posaçme pikërisht nga institucionet rregullatore.

Aktiviteti i tyre kontrollohet dhe monitorohet nga inspektoriate të veçanta të cilat kanë për qëllim të garantojnë standardet dhe cilësinë e shërbimit për klientët. Ato gjithashtu pajisen me liçensa apo leje të posaçme pikërisht nga institucionet rregullatore.

LEGJISLACIONI TATIMOR që ato duhet të zbatojnë është:

-ligjin nr. 9920 ”Për procedurat tatimore në RSH-së dhe udhëzimi në zbatim të tij nr. 24 “Për procedurat tatimore në RSH-së,

-ligjin nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe udhëzimi në zbatim të tij nr 5 “Për tatimin mbi të ardhurat”,

-ligjin 92 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH-së” nëse kanë zgjedhur të jenë subjekte të Tvsh-së dhe udhëzimi në zbatim të tij nr. 6 “Për Tvsh”-në ,

-ligji nr. 9632 Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë dhe udhëzimi në zbatim të tij nr. 23 Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

-ligji nr.9632 “Për sistemin e taksave vendore” si dhe udhëzimin Nr. 32 Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël etj

-Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë

Me ndryshimet më të fundit të gjitha bizneset që kanë patur qarkullim më të vogël se 10 milion lekë janë çrregjistruar nga përgjegjësia tatimore e TVSH-së duke filluar nga data 01 Janar 2021.

Biznes i vogël në aspektin tatimor është cdo subjekt i cili realizon një xhiro vjetore më të vogël ose baraz me 8 milion dhe quhen subjekte të tatim fitimit të thjeshtuar.

FORMA LIGJORE

Këto njësi ekonomike mund të krijohen në një nga format që parashikon ligji nr 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe regjistrohen në QKB (qendra kombëtare e biznesit) sipas ligjit Nr. 9723 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Forma më e përhapur është forma e organizmit si Person Fizik i cili në gjuhën e këtij ligji këta persona quhen “TREGTAR”. Sigurisht që ato mund të organizohen dhe si shoqëri tregtare ku forma më e përhapur është forma e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ose shkurt SHPK e cila është dhe forma që do t’i referohemi në këtë trajnim.

Ligji nr 9901 rregullon pikërisht statusin e tregtarit, themelimin dhe administrimin e shoqërive tregtare, të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, të ortakëve dhe aksionarëve, riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive tregtare.

Ndryshimi mes dy formave:

- Përgjegjësia ndaj palëve të treta

Personi fizik ka përgjegjësi të pakufizuar dhe përgjigjet me pasurinë e tij personale.

Personi juridik (SHPK-të) kanë përgjegjësi të kufizuar deri në masën e kapitalit themeltar.

- Marrëdhënia e investitorëve të kapitalit me njësinë ekonomike

Tregtari është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, i cili ushtron veprimtari ekonomike të pavarur, që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm. Tregtari nuk ka personalitet juridik të ndarë nga njësia ekonomike nga ku buron dhe përgjegjësia e tyre e pakufizuar ndaj palëve të treta.

Shpk-ja kërkon një organizim të veçantë dhe ortakët e shoqërisë kanë personalitet juridik të ndarë nga shoqëria nga ku buron dhe përgjegjësia e kufizuar ndaj palëve të treta.

- Detyrimet tatimore

Pavarësisht formës së organizimit të biznesit detyrimet tatimore janë përgjithësisht të njëjta përveç tatimit në burim dhe konkretisht tatimi mbi ndarjet e fitimit të cilën në gjuhën e përditshme e quajmë *Tatimi mbi dividendin* për të mos u ngatërruar me *tatimin mbi fitimin*. Tatimimbi ndarjet e fitimit është një tatim që aplikohet mbi shumën e fitimit të shpërndarë ortakëve të

SHPK-së pikërisht sepse ortakët kanë personalitet juridik të ndarë nga shoqëria dhe në rastin e shpërndarjes së fitimit ata janë përfitues të kësaj të ardhure dhe detyrohen të paguajnë tatim në burim për të ardhurën e përfituar si individë.

RAPORTIMI TATIMOR

Pavarësisht formës ligjore, çdo biznes i vogël ka detyrimin të bëjë deklaratimet si më poshtë:

1. E sig 27 Deklarata e të punësuarve për here të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna

Kjo pasqyrë dorëzohet 1 ditë para se punonjësi të fillojë punë dhe brenda 10 ditëve në rast largimi. Punësimi duhet të shoqërohet patjetër me një kontratë pune të shkruar.

Dokumentat që duhet të dorëzojë punonjësi para se të fillojë pune:

1-Dokument identifikimi (kartë identiteti)

2-Raport mjeko ligjor

3-Librezë punë

4-Diplomë

Menjëherë punonjësi duhet të hapë llogari bankare për kalimin e pagave nëpërmjet sistemitbankar.

2. E sig 25 Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi

Kjo listëpagesë ka për qëllim të evidentojë pagën e punonjësve si dhe detyrimet që lindin nga kjo marrëdhënie punësimi për sigurime shoqërore/shëndetësore si dhe TAP (tatim mbi të ardhurat nga punësimi), detyrime të cilat ndahen mes punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Paga minimale në shkallë vendi është 30 000 lekë. Asnjë punonjës nuk mund të punësohet me një pagë mujore bruto më të vogël se 30 000 lekë.

Sigurimet shoqërore e shëndetësore llogariten 16.7% punëdhënësi dhe 11.2% punëmarrësi

Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi – TAP-i llogaritet si më poshtë:

0-30 000 lekë	0%
30 001-150 000	13%
Mbi 150 000 lekë	23%

Deklarimi bëhet mbi baza 3-mujore brenda datës 20 të muajit që pason 3-mujorin. Rekomandohet të bëhen çdo muaj për të mos harruar deklarimin dhe pagesën e tatimeve të cilat mund të jenë mujore siç është tatimi në burim.

Në formën Person Fizik, personi që ka regjistruar këtë aktivitet tregtar quhet i vetëpunësuar dhe llogarit e paguan sigurime shoqërore mbi pagën minimale 30 000 lekë dhe sigurimet shëndetësore llogariten mbi 2-fishin e pagës minimale. Ai është i lirë të vendosë nëse do ti paguajë sigurimet shoqërore e shëndetësore për një nivel më të lartë se paga minimale në shkallë vendi deri në kufirin e pagës maksimale, për të përfituar nga skemat e sigurimeve shoqërore siç janë përfitimet për paaftësi të përkohshme , pensionet etj.

3. Tatimi në burim

Një nga format më tipike të tatimit në burim është tatimi i qerasë kur përfituesi apo qiradhënësi është një individ. Tatimi në burim mbahet dhe për çdo pagesë tjetër të bërë për interesat e paguara, dividendët në shoqëritë aksionare apo shpërndarjet e fitimit kur forma juridike është SHPK dhe gjithmonë kur përfituesi i tyre është një individ apo një biznes i huaj

Norma e tatimit (përveç tatimi mbi Dividentin)	15%
Norama e tatimit mbi dividendit apo ndarjes së fitimit (SHPK-të)	8%
Deklarimi dhe pagesa	mujor
Afati i deklarimit dhe pagesës:	brenda datës 20 të muajit pasardhës të kryerjes së pagesës

Kujdes:

Nëse keni aktivizuar përgjegjësinë tatimore të tatimit në burim, ky deklaram duhet të bëhet çdo muaj edhe në rast se nuk keni pagesa, objekt i mbajtjes së tatimit në burim.

Përrjashtim gjithashtu nga rregulli i mësipërm është tatimi mbi dividendin i cili duhet të deklarohet maksimumi brenda datës 20 të muajit që pason vendimmarrjen për shpërndarjen e fitimit por periudha e fundit që mund të bëhet ky deklaram është muaji Korrik. Nëse deklarimi bëhet për muajin Korrik afati për të bërë këtë deklaram dhe pagesën e tatimit është data 20 Gusht.

Tatimi në burim deklarohet dhe paguhet brenda datës 20 të muajit pasardhës të kryerjes së pagesës por **deklarohet çdo muaj pavarësisht nëse ke pagesë apo jo**, përveç tatimit mbi dividendin i cili deklarohet dhe paguhet brenda datës 20 Gusht për fitimit e vitit të kaluar.

4. Vendimi i organit përgjegjës për miratimin e llogarive dhe caktimin e fitimit për personat juridik (SHPK-të si një nga format më të përhapura por termi i duhur është person juridik)

Deri para disa vitesh ky vendim hartohej nga të gjitha njësitë ekonomike person fizik apo juridik gjë e cila ishte në kontradiktë me ligjin 9901”Për shoqëritë tregtare”, pasi një person fizik (Tregtar) nuk ka në strukturën e tij të organizimit një asamble që qeveris njësinë ekonomike. Asambleja apo organe të tjera drejtuese kanë shoqëritë tregtare ashtu siç e përcakton ligji nr 9901i ndryshuar. Me rregullimet që i janë bërë ligjit nr 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat” ai përcakton që personat juridik kanë detyrimin të miratojnë llogaritë vjetore pavarësisht nëse rezultati është 0 apo me humbje si dhe të bëj caktimin e fitimit për rezultatet pozitive. Ky vendim merret brenda 6 muajve të parë të vitit pasardhës dhe dorëzohet në institucionin e tatimeve dhe në QKB brenda datës 31 Korrik.

Në praktikën e përditshme, për të shmangur një penalitet të mundshëm, personat fizik vijnë të marrin këtë vendim dhe ta raportojnë në institucionin tatimor nëpërmjet e-filing dhe në QKB për të shmangur ndonjë penalitet.

Përfundim:

Vendimi ka të bëjë me personat juridik (SHPK-të, aksionare etj)

Nuk ka rëndësi se cili është rezultati (fitim, humbje apo zero)

Nuk ka rëndësi përgjegjësia tatimore Tatim Fitimi / Tatim Fitimi i Thjeshtuar

5. Deklarata e TVSH dhe librat e blerje shitjes në rast se jeni i regjistruar në përgjegjësinë tatimore TVSH.

- Librat e blerjes & shitjes dorëzohen brenda datës 10 të muajit pasardhës nëpërmjet e-filing

-Deklarata e Tvsh-së dhe pagesa kryhet brenda datës 14 të muajit pasardhës

Në këtë periudhë tranzitore është parashikuar që dorëzimi i librave të shitjes & blerjes si dhe deklarata e tvsh-së do të vijojnë të deklarohen manualisht nëpërmjet e-filing deri në dhjetor 2021. Megjithatë ecuria e fiskalizimit do të përcaktojë nëse do të ketë një shtyrje të mëtejshme të deklarimit të tyre nëpërmjet e-filing apo do të bëhet në mënyrë automatike pas rregullimeve të Tvsh-së, nëpërmjet platformës Self Care.

6. Dokumentacioni për njësitë ekonomike subjekte të tatimit mbi fitimin e biznesit të vogël.

Janë subjekte të tatim fitimit të thjeshtuar të gjitha ato subjekte që në momentin e çeljes kanë parashikuar xhiro 0-8 mil dhe mbeten në këtë përgjegjësi tatimore përsa kohë që qarkullimi i tyre vijon brenda këtyre niveleve. Është udhëzimi nr 32 Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, që përcakton dokumentacionin që duhet të mbajnë këto subjekte edhe pse ky udhëzim nuk është përditësuar qoftë me ndryshimet që ka pësuar ligji nr 9632 “Për sistemin e taksave vendore” në lidhje me normën e tatim fitimit por qoftë dhe me ndryshimet që kanë ndodhur për sa

i përket legjislacionit të fiskalizimit. Fiskalizimi ende është në hapat e parë që do të thotë për të gjitha bizneset ka paqartësi për librat që duhet të mbajnë dhe deklarojnë.

Megjithatë në këtë fazë tranzitore të gjitha subjektet vijojnë të dorëzojnë manualisht njësoj si më parë dhe duke u ndodhur në këtë fazë tranzitore udhëzimi nr 32 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël parashikon që subjektet me xhiro nga 2-8 milion janë të detyruar të mbajnë:

- a) librin e shitjeve, ku regjistrojnë në mënyrë kronologjike çdo shitje të kryera me faturë të fiskalizuar
- b) librin e blerjeve ku regjistrojnë në mënyrë kronologjike çdo blerje të kryer me faturë të fiskalizuar
- c) libri i shpenzimeve dhe të ardhurave;
- d) librin e aktiveve të biznesit

Forma dhe përmbajtja e librit të shitjeve, librit të blerjeve, librit të shpenzimeve dhe të ardhurave, librit të aktiveve të biznesit, janë sipas formularëve përkatës, shtojcat nr 2, shtojca nr.3, shtojca nr.4, shtojca nr.5, shtojca nr.6 dhe shtojca nr.7, bashkëngjitur këtij udhëzimi (nr 32). Në vijim pritet të dalin udhëzime të reja përse i përket librave që duhet të mbajnë një njësi ekonomike subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël ku librat e blerjes dhe të shitjes janë plotësime automatike të platformës Self – Care.

Këtyre subjekteve ju është dhënë e drejta të zgjedhin nëse duan të jenë pjesë e skemës së tvsh -së. Për ato subjekte që kanë zgjedhur të jenë pjesë e skemës së Tvsh-së mbahen librat e blerjes dhe të shitjes sipas ligjit 92 “për Tvsh-në” dhe deklarohen brenda datës 10 të muajit pasardhës nëpërmjet platformes e-filing, siç jemi shprehur dhe në pikën 5, këtu më lart

7. Deklarata vjetore e tatim fitimit të thjeshtuar

Kjo deklaratë plotësohet dhe dorëzohet brenda datës 10 shkurt të vitit pasardhës pavarësisht se norma e tatimit të thjeshtuar është 0% .

Raportimi Financiar

Pavarësisht se udhëzimi nr 32 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël” ka përcaktuar formatin e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve për njësitë ekonomike që kanë xhiro 2-8 milion, në njoftimet zyrtare ata kanë referuar këtë format për subjektet biznes i vogël që kanë realizuar një qarkullim 2-5 milionë lekë duke qënë në një linjë dhe me SKK- 15.

Sipas SKK 15, zbatojnë dhe raportojnë sipas këtij standardi të gjitha njësitë ekonomike që realizojnë jo më pak se 5 milion lekë dhe jo më shumë se 30 milion lekë të ardhura nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi).

Sipas Ligjit për Kontabilitetin² në Republikën e Shqipërisë duhet të përgatishni disa pasqyra financiare për t'u raportuar në baza vjetore dhe më të rëndësishmet ndër to janë Bilanci Kontabël, apo sic njihet ndryshe Pasqyra e Pozicionit Financiar, dhe Pasqyra e Performancës apo siç njihet edhe si Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve. Kuadri ligjor që rregullon ndërtimin dhe formatin e Pasqyrave Financiare specifikon ngarkesë më të lehtësuar kontabël për bizneset e vogla (vetëm Bilancin Kontabël dhe Pasqyrën e të Ardhurave), dhe ndërtimin e pasqyrave financiare të plota për bizneset e mesme dhe të mëdha. Konkretisht është Standardi Kombëtar i Kontabilitetit (SKK) 15 i cili kërkon që mikronjësitë³ të përgatisin tre dokumente si pjesë të pasqyrave financiare vjetore:

1. Pasqyra e pozicionit financiar;
2. Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve (PASH), dhe,
3. Shënimet Shpjeguese

Bilanci Kontabël

Bilanci ju jep një lloj fotografie të pozicionit financiar të biznesit tuaj në një moment të dhënëkohe.

Bilanci përbëhet nga tre seksione ose pjesë:

- **Aktivitet** – këto janë të gjitha pasuritë që disponohen nga biznesi, si makineri, pajisje, inventare, para, etj
- **Detyrime** – Paratë që biznesi juaj i detyrohet palëve të treta si furnitorë, banka, shteti, kreditorë, etj
- **Kapital** – Shuma që vetë pronarët kanë investuar në biznes plus të gjitha fitimet që mund të jenë akumuluar në vite nga aktiviteti i firmës.

² <https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/ligj-nr.-25-dt.-10.5.2018.pdf>

³ Sipas SKK 15, mikronjësi ekonomike quhen njësitë ekonomike, që në datë raportimit nuk tejkalojnë kufijtë e të paktën dy prej tri kriterëve të mëposhtme: a) aktivi, 15 milionë lekë; b) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), 30 milionë lekë; c) numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 10. Këto kriterë duhet të plotësohen për dy vite të njëpasnjëshme.

Këto tre pjesë të informacionit financiar të biznesit mund të përdoren në cdo kohë për të llogaritur vlerën neto të biznesit. Një bilanc që tregon vlerë pozitive pra, ku aktivet totale janë më të larta se shuma e detyrimeve dhe e kapitalit tregon se biznesi juaj ka baza financiare të forta.

Bilanci shërben gjithashtu për t'u dhënë palëve të treta si banka, apo investitorë potencialë një pamje të qartë sesi po financohet biznesi dhe si është shëndeti financiar i tij.

Në vijim jepet një bilanc kontabël i thjeshtuar për një firmë tipike shqiptare.

Nr.	AKTIVET	X1	X0
I	AKTIVET AFATSHKURTRA		
	Aktivet monetare	43,428	10,123
	Të drejta të arkëtueshme :	182,885	251,188
	Nga aktiviteti i shfrytëzimit nga klientet	175,160	245,942
	Tatim mbi fitimin	1,764	766
	TVSH	1,480	-
	Te tjera	4,480	4,480
	Inventarët:	14,508	1,343
	Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	8,674	1,343
	Parapagime per inventar	5,834	-
	AKTIVE TOTALE AFATSHKURTRA	240,821	262,654
II	AKTIVE AFATGJATA		
	Aktive Afatgjata Financiare:	-	-
	Aktive Afatgjata Materiale: (Makineri, pajisje)	59,814	53,564
	Aktivet Biologjike Afatgjata	-	-
	Aktive Afatgjata Jo Materiale	-	-
	AKTIVE TOTALE AFATGJATA	59,814	53,564
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)	300,635	316,218

Nr.	DETYRIMET DHE KAPITALI	X1	X0
-----	------------------------	----	----

	DETYRIMET AFATSHKURTRA		
	Detyrimet Afatshkurtra		
	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit ndaj furnitoreve	94,322	139,651
	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit	155,728	109,568
	Të pagueshme ndaj punonjësve	844	695
	Të pagueshme ndaj sigurimeve shoqërore	271	223
	Të pagueshme për detyrimet tatimore TVSH		268
	Dividend per t'u paguar	37,642	
	TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTRA	288,807	250,405
	DETYRIMET AFATGJATA	-	-
	TOTALI I DETYRIMEVE (I + II)	288,807	250,405
	Kapitali dhe Rezervat		
	Kapitali i Nënshkruar	100	100
	Rezerva Ligjore	2,425	2,425
	Rezerva te tjera		46,080
	Fitimi i pashpërndarë		
	Fitim / Humbja e Vitit	9,303	17,208
	TOTALI I KAPITALIT	11,828	65,813
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	300,635	316,218

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve (PASH)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve është mjete më i mirë për të ditur nëse biznesi juaj është me fitim apo me humbje gjatë një periudhe aktiviteti. Kjo pasqyrë tregon të ardhurat (nga aktiviteti apo shitjet) dhe shpenzimet për periudha shpesh një vjeçare, por mund të përgatitet edhe për periudha një, tre ose gjashtë mujorë. Çdo vendim që keni marrë në lidhje me çmimet e ofrimit të aktiviteteve, çmimet e blerjes së shërbimeve të ndryshme do pasqyrojë efektin e vet pikërisht në këtë pasqyrë.

Në thelb pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve reflekton këtë barazim:

Rezultati (fitim ose humbje) = Të ardhura – Shpenzime.

Në mënyrë më të detajuar, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve do të ketë këto zëra:

- **Të ardhurat** – nga shitjet apo nga aktiviteti i shfrytëzimit. Ky zë paraqet të ardhurat totale që keni përfituar nga shitja e shërbimeve tuaja gjatë një periudhë të caktuar. Kujdes! Në këtë zë përfshihen edhe ato fatura që ju i keni përpiluar, i keni dërguar tek klienti por nuk i keni arkëtuar akoma. *Përse? Kjo njihet si parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në kontabilitet (accrual accounting) dhe kërkon që të ardhurat (por edhe shpenzimet) të regjistrohen në systemin e informacionit kontabël jo atëherë kur paguhen ose arkëtohen paratë por kur ndodh transaksioni dhe lindin të drejta dhe detyrime mes palëve në transaksion.*
- **Kostoja e mallrave të shitura**- Ky zë paraqet shpenzimet totale për zërat e inventarit që blihen nga klientët dhe zakonisht përfshin elemente si kostoja e blerjes së mallrave, shpenzimet e transportit në blerje, kosto prodhimi dhe paketimi, etj. *Në rastin e firmave që ofrojnë shërbime (si ato në sektorin blu), ky zë përfshin kostot e ofrimit të shërbimit përfshi edhe punën, materialet e konsumuara gjatë shërbimit dhe transportin.*
- **Fitimi Bruto**- Është i barabartë me Të ardhura minus Kosto e Mallrave të Shitura.
- **Shpenzime operative të përgjithshme**- Në këtë zë përfshihen shpenzime që lidhen me mbarëvajtjen e vazhdueshme të biznesit si psh qeraja, taksat e bashkisë, faturat e UKT dhe OSHEE, etj. Shpesh për ta pasur më të lehtë shpenzimet në këtë kategori grupohen në shpenzime që lidhen me shpërndarjen e produkteve tek klienti dhe shpenzime që lidhen me administrimin e përgjithshëm të njësisë ekonomike.
- **Fitimi neto**- Është i barabartë me fitimin bruto minus shpenzimet operative. Fitimi neto është ajo çfarë mbetet për të paguar (me radhë), interesat e huave, tatimin mbi fitimin, blerjen e pajisjeve të reja, zgjerimin e biznesit dhe tërheqjet e pronarit.

	Të ardhura të shfrytëzimit
minus:	Kosto të mallrave të shitura
baras:	Fitimi / Humbja Bruto
minus:	Shpenzime të Shpërndarjes

minus:	Shpenzime Administrative
baras:	Fitimi / Humbja operative

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas Ligjit Shqiptar mbi Kontabilitetin dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit do të dukej si më poshtë (shembull real me një biznes të vogël të vendit tonë):

Nr.	Pershkrimi i Elementeve	X1	X0
1	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	1,919,170	895,783
2	Ndrysh ne invent prod gatshme e prodhimit ne proces		
3	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar		
4	Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit	-	-
5	Materialet e konsumuara	(564,389)	(305,891)
6	Shpenzime të personelit	(684,391)	(513,491)
7	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	-	-
8	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	(90,240)	(36,732)
9	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	(620)	-
10	Të ardhura të tjera	-	-
11	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra	-	-
12	Shpenzime financiare (jo interesa)	(2,372)	(682)
13	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		
14	Fitimi (humbja) para tatimit	577,158	38,987
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	(138,025)	(11,405)
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)	439,133	27,582

FISKALIZIMI

Fiskalizimi në aspektin konceptual është një sistem i ri administrimi dhe raportimi në kohë reale të aktivitetit ekonomik i cili ka në fokus ata që nuk deklarojnë dhe nuk paguajnë detyrimet e tyre në përputhje me ligjin. Me këtë proces të ri të raportimit financiar, sigurohet një kontroll më i mirë dhe inspektim më efikas tatimor, ndërsa i jepet mundësia çdo qytetari, që të verifikojë nëse taksat që ai paguan për mallrat dhe shërbimet, deklarohen në sistemin tatimor. Fiskalizimi në thelb nuk ka asnjë ndryshim për tatimpaguesit e rregullt, përkundrazi ai thjeshton një sërë operacionesh brenda njesisë ekonomike.

Ligji Nr.87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" dhe ndryshimet që ai sjell, nuk prodhojnë asnjë ndryshim në skemën aktuale të taksave. Për të gjithë tatimpaguesit që deklarojnë dhe paguajnë këto detyrime, nuk ka asnjë ndryshim në peshën e detyrimeve të tyre.

Përse shërben fiskalizimi?

1- Formalizimi i ekonomisë duke identifikuar personat që nuk paguajnë taksat dhe zgjerim i fashës së tatimpaguesve

2- Krijon shanse për uljen e taksave- Formalizimi i ekonomisë zgjeron rrethin e tatimpaguesve, duke ndërtuar kështu shanse reale për uljen e taksave.

3- Modernizon biznesin duke përdorur më pak letër dhe duke u bërë më eficient

4- Të shmangë jo-paguesit- Nëpërmjet gjurmimit të pagesave të faturave elektronike, identifikohen personat që nuk kanë aftësi paguese të cilët çenojnë gjithë sistemin financiar të vendit.

5- Anëtarësimi në BE. Modernizimi i sistemit tatimor, transparenca në të bërit biznes, përdorimi i faturës elektronike (e-fatura - në përputhje me normat e Bashkimit Europian), janë të gjitha parapërgatitje të domosdoshme, që do të na ndihmojnë në rrugëtimin tonë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian.

POR: A është biznesi i vogël i gatshëm për këtë modernizim?

Jo, dhe kjo është ndoshta pika më vulnerabël e fiskalizimit përveç problematikave të mëdha funksionale të shfaqura që në ditët e para të implementimit të tij si softuer por dhe nga aspekti i ndryshimeve ligjore që kërkon implementimi i një sistemi të tillë.

Termet dhe konceptet që duhet të kuptohen janë:

1-Çertifikata elektronike për projektin e fiskalizimit

Çertifikata elektronike garanton autenticitetin e leshuesit të faturave tatimore duke bërë lidhjenmes softwear-it në përdorim nga tatimpaguesi për lëshimin e faturave dhe platformës qendrore të faturave e quajtur ndryshe platforma Self Care me qëllim fiskalizmin dhe raportimin në kohë reale të kësaj fature.

2-Sistemi i Fiskalizimit

Sistemi i fiskalizimit është tërësia e pajisjeve fiskale dhe zgjidhjeve software-ike që mund të përfshijë dhe çdo zgjidhje software-ike të ndërmjetme që përdoren për lëshimin dhe marrjen e faturave, të faturave shoqëruese etj, zbatimin e procedurave të fiskalizimit dhe shkëmbimit elektronik të mesazheve, komunikimit ndërmjet tatimpaguesve që lëshojnë fatura,fatura shoqëruese, dhe sistemit të teknologjisë së informacionit të administratës tatimore qendrore, duke përdorur një rrjet të sigurt të shkëmbimit të të dhënave nëpërmjet lidhjes elektronike, internetit. Sistemi i fiskalizimit përdoret, gjithashtu, për shkëmbimin elektronik të mesazheve dhe komunikimin ndërmjet bankave, institucioneve financiare jobankare dhe subjekteve të tjera, që ofrojnë shërbime pagese të faturave elektronike, dhe sistemit të teknologjisë së informacionit të administratës tatimore qendrore.

Sistemi i fiskalizimit përfshin:

i Pajisja fiskale e cila përbëhet nga :

- pajisja elektronike që mundëson lëshimin e faturës qoftë faturat e lëshuara për pagesat **me para në dorë**, faturat shoqëruese apo faturat e lëshuara **për pagesa pa para në dorë**
- Printeri që mundëson printimin e faturës të lëshuar për pagesa pa para në dorë dhe faturatshoqëruese
- ii Zgjidhja softwar-ike** në formën e një aplikacioni individual, një sistem të integruar kompjuterik apo një aplikacioni Cloud i cili mundëson:
 - përpilimin e faturës ose faturës shoqëruese, futjen e të gjitha elementeve të domosdoshëm të faturës ose faturës shoqëruese;
 - identifikimin e operatorit që lëshon faturën ose faturën shoqëruese;
 - nënshkrimin elektronik;
 - lëshimin dhe pranimin e faturave elektronike;
 - transferimin automatik të të dhënave në administratën tatimore qendrore dhe pranimin e

informacionit konfirmues nga administrata tatimore qendrore, pas verifikimit automatik të çdofature ose fature shoqëruese;

- ruajtjen e të dhënave në memorie;

- masa të tjera për procedurën e fiskalizimit;

iii. zgjidhja software-ike, në formën e një aplikacioni individual ose të një sistemi të integruar kompjuterik apo një aplikacioni Cloud, që mundëson nënshkrimin elektronik, transferimin automatik të të dhënave në administratën tatimore qendrore dhe pranimin e mesazhit konfirmues nga administrata tatimore qendrore, pas verifikimit automatik të mesazhittë pagesës së një fature elektronike;

iv. sistemi i komunikimit ndërmjet tatimpaguesit, që lëshon fatura ose fatura shoqëruese, dhe administratës tatimore qendrore apo ndërmjet bankave, institucioneve financiare dhe ndërmjetësve të tjerë, të cilët ofrojnë shërbime pagese të faturave elektronike dhe administrates tatimore qendrore, nëpërmjet rrjetit të sigurt për transferimin elektronik të të dhënave në internet.

3-“Faturë” është çdo dokument në letër ose në formë elektronike, që përmbush kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

4-“Faturë elektronike” është fatura e lëshuar, dërguar dhe pranuar në format elektronik, që lejon përpunimin e saj automatik dhe elektronik.

5- “Faturë shoqëruese” është një dokument transporti, që përdoret për shoqërimin e lëvizjes së mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur nuk ka transferim të pronësisë mbi mallrat.

6-“Numri identifikues i veçantë i faturës (NIVF)” dhe “Numri identifikues i veçantë ifaturës shoqëruese (NIVFSH)” janë të dhëna të veçanta dhe të papërsëritshme alfanumerike të çdo fature dhe fature shoqëruese, të lëshuar nga tatimpaguesi. Këto të dhëna i gjeneron sistemi informatik i administratës tatimore qendrore, sipas rregullave të caktuara, nëse përmbushen të gjitha kontrollet gjatë procesit të verifikimit të faturës dhe faturës shoqëruese.

7- “Numri i sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF)” dhe “Numri i sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH)” janë të dhëna të veçanta dhe të papërsëritshme alfanumerike të çdo fature dhe fature shoqëruese. Këto të dhëna gjenerohen nga sistemi i tatimpaguesit, lëshuesi

faturës dhe faturës shoqëruese, duke konfirmuar lidhjen ndërmjet tatimpaguesit dhe faturës ose faturës shoqëruese të lëshuar.

8-“Numri unik i identifikimit” është numri personal identifikues i një individi, ose NIPT/NUIS, me të cilin pajisen personat fizikë dhe juridikë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për regjistrimin e biznesit dhe për procedurat tatimore. Për personin jorezident, i cili nuk është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, nuk është pajisur me numrin e tij të identifikimit ose NIPT/NUIS dhe nuk është subjekt i tatimeve në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin tatimor, për qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit, numri unik I identifikimit konsiderohet numri identifikues tatimor ose numri identifikues personal i lëshuar në vendin e tij të rezidencës.

9- “Operator” është individi, që përpilon dhe lëshon fatura nëpërmjet sistemit fiskal, ose personi i autorizuar nga tatimpaguesi, që lëshon faturë, për të lëshuar fatura nëpërmjet sistemit fiskal. Në rastet e shitjeve nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit (automatët), operator konsiderohet tatimpaguesi që lëshon faturën. Në rastet e lëshimit të faturës shoqëruese, operatori është individi, i cili lëshon faturën shoqëruese nga pajisja elektronike.

10- “Pagesë me para në dorë” është pagesa për mallrat ose shërbimet e furnizuara, kryer me kartëmonedha ose monedha, të cilat konsiderohen mjete të ligjshme pagese, në përputhje me legjislacionin përkatës dhe, për qëllim të këtij ligji, përfshijnë edhe kartat e debitit, kreditit, çequet.etj

11- “Pagesë pa para në dorë” është pagesa për mallrat ose shërbimet e furnizuara, kryer nëpërmjet një banke, institucioni financiar jobankar ose subjekteve të tjera, që ofrojnë shërbime pagese, ose institucioneve të tjera të parasë elektronike, të licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe që, për qëllim të këtij ligji, përfshin të gjitha mënyrat e tjera të pagesës, të cilat nuk konsiderohen pagesa me para në dorë, sipas pikës 10 më lart

Hapat që duhen ndjekur për të fiskalizuar biznesin janë:

1-Çertifikata elektronike për projektin e fiskalizimit

Kjo certifikatë sigurohet nëpërmjet aplikimit në llogarinë e tatimpaguesit në e-albania.

Para se të bëhet aplikimi duhet të bëhet pagesa me formularin TIP i cili shkarkohet nëpërmjet e-albanias në të njëjtin funksionalitet dhe ku ngarkohet kjo pagesë për të finalizuar aplikimin për sigurimin e kësaj certifikate.

2-Përzgjedhja e ofruesit dhe mirëmbajtësit të zgjidhjes softëar-ike

Është detyrim ligjor lidhja e kontratës me ofruesin dhe mirëmbajtësin e zgjidhjes softëar-ike

3-Sigurimi i një linje interneti (kontratë me ofruesin e internetit)

4-Sigurimi i pajisjeve elektronike

5-Sigurimi i një printeri që mundëson printimin e faturave me para në dorë si dhe faturave shoqëruese

6- Konfigurimet fillestare në platformë në lidhje me:

- vendet e ushtrimit të aktivitetit
- përcaktimi i NVE-ve,
- përcaktimi i pajisje elektronike të faturimit (Arkat),
- përcaktimi i operatorëve,
- përcaktimi i orareve të punës ,
- përcaktimi vendndodhjes në hartë etj,

Këto konfigurime përfshi dhe operatorët duhet të bëhen një ditë para se të fillojë procesi i faturimit të mallrave dhe shërbimeve.

Për shitjet me lekë në dorë duhet të bëhet deklarimi fillestar i parave në arkë si dhe çdo lëvizje (tërheqje apo depozitime) që mund të bëhen gjatë ditës

Financimi i biznesit

Trajtat dhe format thelbësore të financimit të biznesit janë:

- **Financimi nga pronari (kapitali).** Avantazhi i kësaj forme financimi është se nuk ka afat përdorimi dhe mund të qëndrojë për shumë vite në biznes. Për shumicën e biznesve të vogla, kapitali vjen nga pronari ose nga kursime familjare, ose edhe nga hua informale të marra nga familja / fisi. Shpesh për bizneset e vogla start-up kjo është e vetmja formë financimi.
- **Financimi me borxh/hua.** Huatë janë fonde që duhet të kthehen mbrapsht pas disa vitesh pra kanë një afat përdorimi. Vec kësaj borxhet kanë interesa që duhen paguar sipas afateve të përcaktuara në kontratën e huasë. Në disa raste huadhënësi (një bankë apo një shoqëri krediti si iutecredit, etj, mund të vendosë edhe kushte të tjera në marrëveshjen e financimit, psh që xhiroja vjetorë te mos ulet nën një nivel specifik, apo që të mos merrni hua të tjera për disa vite të ardhshme, etj.

- **Kapitali punues**-Lidhet me “financimin” e tërthortë nëpërmjet blerjes me pagesë të mëvonshme (njihet edhe si blerje me kredi) e inventarëve apo pajisjeve të ndryshme. Shpesh kjo formë financimi është afatshkurtër (deri në disa muaj), por ka si avantazh që nuk shoqërohet me kosto të deklaruara interesi. Në thelb është financim që j’u bëhet nga furnitorët, por edhe bankat kanë hyrë në këtë treg financimi duke ofruar ato që njihen si kredi për kapital punues, që janë kredi afatshkurtra (deri në 9 muaj) nëpërmjet të cilave mund të financoni aktivitetin operativ të biznesit.
- **Financimi i aktiveve afatgjata** – (leasing) Zakonisht ky lloj financimi përdoret në rastet kur blihen pajisje, mjete motorrike apo prona të patundshme. Shoqëritë e leasingut ju ofrojnë që të bëni tuajën aktivin/mjetin afatgjatë për të cilin keni nevojë ndërkohë që paguani me këste (pra ngjason me blerjen më këste vetëm se në kontratën e lizingut, këstii paguar përfshin në mënyrë të fshehur edhe interesin e llogaritur).

Avantazhet dhe disavantazhet e financimit me kapital

Avantazhe:

- **Riks më i ulët:** meqë financimi me kapital nuk kërkon pagesa të përmuajshme interesash apo këste të plota nënkupton më pak risk.
- **Flukse monetare më të mira:** Financimi me kapital nënkupton që paratë nuk dalin nga biznesi, pra rriten paratë gjendje dhe ulet ndjeshëm nevoja për huamarrje nga jashtë firmës në rast nevojë për zgjerim të biznesit.
- **Planifikim afatgjatë:** Investitorët e kapitalit zakonisht nuk presin të marrin një kthim të menjëhershëm nga investimi i tyre, cka i jep liri biznesit të bëjë plane afatgjata dhe të ndërmarrë vendime në afat të gjatë.

Disavantazhe:

- **Kostoja:** Investimi me kapital nënkupton nivel risku të konsiderueshëm, ndaj investitorët (ortakët) do të presin të kenë një pjesë të konsiderueshme nga biznesi. Pjesa e fitimeve të firmës që atap resin të marrin mund të jetë edhe më e lartë sesa kostoja e interesave të huave.

- **Humbja e kontrollit:** Pronari i biznesit do humbasë një pjesë të kontrollit mbi firmën e tij duke qenë se ortakë të tjerë do hyjnë në strukturën e pronësisë dhe ata duhen marrë parasysh kur merren vendime të rëndësishme biznesi.
- **Mundësia për konflikt:** Investitori (ortaku i ri) jo gjithmonë mund të jetë dakord me vendimet për biznesin cka sjell konflikte potenciale mes ortakëve.

Avantazhet dhe disavantazhet e financimit me hua

Avantazhe:

- **Kontrolli mbi biznesin nuk dobësohet:** marrja e një huaj është e përkohshme. Huadhënësi nuk ka të drejtë të ndërhyjë në vendimet e biznesit dhe marrëdhënia biznes – kreditor merr fund kur shlyhet huaja.
- **Kostoja e financimit me hua është e zbritshme para tatimeve:** Interesi i paguar për një hua është shpenzim i zbritshëm para llogaritjes së fitimit të tatueshëm. Ndërkohë dividendët që i shpërndahen pronarëve nuk janë të tilla madje edhe taten.
- **Është i parashikueshëm:** Firma e di me saktësi sa do t'i duhet të paguajë për borxhin cdo muaj kështu që mund të planifikojë në avancë.

Disavantazhe:

- **Pagesat janë fikse:** Parashikueshmëria e kësteve të huasë mund të jetë avantazh por nuk ka fare fleksibilitet për shumat apo kohën e shlyerjes së tyre nëse keni rënie të likuiditetit për një arsye apo një tjetër.
- **Siguria:** kreditorët zakonisht do kërkojnë siguri dhe garanci për huatë që do japin dhe zakonisht ia “vënë syrin” pasurive të biznesit si makineri pajisje etj. Nëse huaja nuk shlyhet këto pasuri mund të jenë në risk për t'u sekuestruar nga shoqëritë e përmbarimit. Ka pastaj situata edhe më ekstreme kur pronarit i duhet të garantojë huatë e biznesit me pasuri personale si apartamenti familjar.
- **Kualifikimi:** Jo cdo biznes do të pranohet e kualifikohet për të marrë hua.
- **Flukset monetare:** Këstet e borxhit “gërryejnë” cdo muaj gjendjen e likuiditetit dhe kanë potencial të pengojnë rritjen e biznesit.

Këshilla mbi financimin e biznesit të vogël:

- **Investoni fillimisht paratë tuaja-**Së pari ju udhet të investoni cfarë dispononi vetë, e më pas të kërkoni për kapital apo hua nga burime të tjera. Nëse përfshiheni me fondet që dispononi vetë, demonstroi seriozitet dhe përkushtim personal në drejtimin e një biznesi të suksesshëm.
- **Fitojeni të drejtën për të marrë hua-** Huamarrja nuk është një e drejtë që ju e keni automatikisht, në fakt është një privilegj që duhet ta fitoni duke treguar aftësi në sipërmarrje. Që të tjerët t'ju besojnë fondet e tyre, duhet të demonstroi kredibilitet dhe aftësi për të menaxhuar mirë borxhin dhe për të drejtuar një biznes me fitim.
- **Tregoni që keni fitime-** Huadhënësit duan të shohin fitime. Sigurohuni që menaxhimi juaj i mirë çon në biznes fitimprurës.
- **Kuptoni dhe ruani nivelin e kapitalit punues-** Kapitali punues përfqëson nivelet optimale të inventarit, klientëve dhe furnitorëve të biznesit. Këto tre elemente duhet të menaxhohen në mënyrë mjeshtrërore për të ruajtur balanca të shëndetshme në bizneset e vogla. Psh klientët dhe furnitorët duhet të jenë pak a shumë të balancuar mes tyre përse i përket shumës, afateve të maturimit, diversitetit (gjeografik, sektorial, etj). Rritja graduale e biznesit duhet të shoqërohet me rritjen e kapitalit punues i cili është i nevojshëm për të suportuar vëllimin e shtuar të transaksioneve.
- **Mos e teproni me investimet në aktive afatgjata-** Shpesh pronarët e biznesve të vogla gabojnë kur mendojnë se u duhet të blejnë shumë pajisje apo makineri për të filluar një biznes apo për t'u rritur. Makineritë dhe pajisjet harxhojnë shumë para, të cilat fare mirë mund të përdoren me mençuri dhe zgjuarsi diku tjetër. Ndaj sa herë është e mundur duhet të mendohen alternativa të tjera për të disponuar aktive të tilla, marrje me qera, psh.
- **Lidhni burimet dhe përdorimet e fondeve-** Një nga rregullat e financimit të kujdesshëm është që inventaret apo klientët (afatshkurtër) të financohen me kredi apo hua afatashkurtra (psh linja kredi apo overdrafte), ndërkohë që makineritë dhe pajisjet (afatgjata) duhet të financohen me kredi apo hua me të njëjtat afate (ndërkohë që përdorni një makineri dhe ajo ju gjeneron fonde, mund të shlyeni interesat dhe këstet e kredisë që keni marrë për të). Jo rrallë ndodh që pronarë të rinj bëjnë gabimin që blejnë makineri dhe pajisje afatgjata duke i financuar me borxh afatshkurtër (që duhet paguar për 6 – 9 muaj). Kjo i sforcon që të shlyejnë huanë para se vetë makineria të gjenerojë fonde për mbulimin e kostos së saj.

- **Mundohuni të kuptoni sa më shumë nga pasqyrat financiare-** Tipikisht seti i pasqyrave financiare përmban jo vetëm pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe pasqyrën e flukseve monetare, por edhe bilancin kontabël, ose sic njihet së fundmi Pasqyrën e pozicionit financiar. Mundohuni të kuptoni sa më shumë nga këto zëra, edhe kur kontabilitetin e mbani nëpërmjet një shërbimi (zyre kontabiliteti).
- **Njihni opsionet që keni për kolateral-** Shumica e huave kërkojnë kolateral apo garanci shpesh në formën e një aktivi që keni apo që do të blini. Për huadhënësin kolateral është granacia që nëse nuk eshlyeni huanë, ata do të marrin këtë mjet nga ju. Përgatituni që më parë të diskutoni mundësitë e kolateralit kur kërkonit hua. A jeni të gatshëm të lini si garanci, pasuri vetiake, personale apo të bëni garant një person të tretë?
- **Njihuni me risqet dhe kostot e alternativave të ndryshme të financimit-** Psh një kartë krediti është e lehtë për t'u përdorur, por kostoja e saj e interesit është goxha e lartë. Më mirë është të merret një kredi afatshkurtër e negociuar dhe të planifikohet me kujdes sesi do të shpenzohet dhe për çfarë do të përdoret kjo kredi.
- **Shqyrtoni disa opsione financimi-** Kërkoni në banka të ndryshme. Shpesh bankat ku ju keni llogari rrjedhëse për pagesat e faturave apo për kalimin e pagave mund të jenë të gatshme që t'ju ofrojnë terma më të favorshme për huatë.

Si të përgatiteni për marrjen e një huaje?

Ndërtoni një plan biznesi. Mënyra më e mirë për te negociuar për një hua është të ndërtoni një plan biznesi të qëndrueshëm që tregon qartë burimet nga do të gjenerohen paratë dhe si do të shlyhet kjo hua në të ardhmen. Plani i biznesit shpesh përgatitet nga shërbime të specializuara dhe duhet të përfshijë një analizë të kujdesshme të tregut, produktit dhe shërbimit që ju ofroni. Plani i biznesit zakonisht përfshin:

- Një deklaratë qëllimi.
- Listoni profilin e pronarit/ëve të biznesit
- Përshkruan biznesin dhe si do të gjenerohet fitimi.
- Pasqyrat financiare të projektuara (pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe ajo e flukseve monetare).
- Dokumenta të nevojshme si referenca, siguracione, kontrata, etj

Shkoni të përgatitur se çfarë mund të përballoni. Llogarisni paraprakisht sa para ju duhen afërsisht dhe sa do jeni në gjendje të përballoni për të paguar çdo muaj. Plani juaj të përfshijë një

plan shlyerje të borxhit me parashikimin e burimeve nga do t'i gjeni fondet për të bërë këto pagesa.

Studioni pasqyrat financiare. Sic u përmend dhe më lart, huadhënësi do t'i hetojë pasqyrat tuaja financiare me shumë kujdes dhe ju duhet të siguronit dokumentacion të plotë suportues për çdo zë në pasqyrat financiare (listën e inventarit apo të makinerive, pagesat e sigurimeve për punonjësit, shlyerjet e detyrimeve tatimore, etj).

Përcaktoni opsionet për kolateralin. Jini të hapur për opsionet e ndryshme për kolateralin. Kur blini një makineri apo pajisje, shpesh rolin e kolateralit e luan pikërisht pajisja e blerë. Por nuk është e rrallë që edhe pasuritë vetiake (një makinë apo apartament) mund të luajnë rolin e një kolateralit në rastin e kredisë për biznesin.

Tregoni kontributin nëpërmjet kapitalit tuaj. Pothuaj në çdo rast që merrni një kredi, banka financon 70 – 90 % të vlerës së investimit dhe ju duhet të demonstroi afërsi që mund të mbështesni 10 – 30 % e mbetur të vlerës totale të projektit ku do investohet.

Referenca:

Ligji Nr. 93/2015 „Për turizmin

Ligji Nr. 25/2018 „PËR KONTABILITETIN DHE PASQYRAT FINANCIARE“

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, nga faqja Keshillit Kombëtar të Kontabilitetit:
<https://www.kkk.gov.al/faqe.php?id=1&l2=136&gj=sh>

Ligji 9901 „Për shoqëritë tregtare“

Ligji Nr. 9723 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Ligji nr. 9920 ”Për procedurat tatimore në RSH-së dhe udhëzimi në zbatim të tij nr. 24 “Për procedurat tatimore në RSH-së,

Ligji nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe udhëzimi në zbatim të tij nr 5 “Për tatimin mbi të ardhurat”,

Ligji 92 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH-së” nëse kanë zgjedhur të jenë subjekte të Tvsh-së dhe udhëzimi në zbatim të tij nr. 6 “Për Tvsh”-në ,

Ligji nr. 9632 Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë dhe udhëzimi në zbatim të tij nr. 23 Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Ligji nr.9632 “Për sistemin e taksave vendore”.

Udhëzimi Nr. 32 Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël etjKodi i Punës
në Republikën e Shqipërisë

Ligji Nr.87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit"